

26 Kodi i Sh. B. § 1472 – Pagesa të mbajtura në burim për entitetet tjera të huaja

(a) Në përgjithësi

Në rast të ndonjë pagese të mbajtur në burim për një entitet të huaj jo-financiar, nëse—

(1) pronari përfitues i pagesës së tillë është entitet i tillë apo ndonjë entitet tjetër jo-financiar, dhe

(2) kërkesat e nën-seksionit (b) nuk janë plotësuar në lidhje me pronarin e tillë përfitues,

Atëherë agjenti i mbajtjes në burim në lidhje me pagesën e tillë do të zbresë dhe do të mbajë nga pagesa e tillë një tatim të barabartë me 30 përqind të shumës së pagesës së tillë.

(b) Kërkesat për heqjen e mbajtjes në burim

Kërkesat e këtij nën-seksioni janë plotësuar në lidhje me pronarin përfitues të një pagese, nëse—

(1) pronari i tillë përfitues apo i paguari agjentit të mbajtjes në burim i ofron qoftë—

(A) një certifikatë se pronari i tillë përfitues nuk ka ndonjë pronar të domethënës të Shteteve të Bashkuara, apo

(B) emrin, adresën, dhe NIT të secilit pronar domethënës të Shteteve të Bashkuara të pronarit të tillë përfitues,

(2) agjenti i mbajtjes në burim nuk e di, apo nuk ka arsye ta dijë, se çdo informacion i ofruar sipas paragrafit (1) është i pasaktë, dhe

(3) agjenti i mbajtjes në burim ia raporton informacionin e ofruar sipas paragrafit (1)(B) Sekretarit në mënyrë të tillë sikurse Sekretari mund ta parasheh.

(c) Përjashtimet

Nën-seksioni (a) nuk do të aplikohet—

(1) përveç nëse nuk parashihet ndryshe nga Sekretari, në çdo pagesë në pronësi e përfituar nga—

(A) çdo korporatë stoku i së cilës tregtohet rregullisht në një treg të themeluar të letrave me vlerë,

(B) çdo korporatë e cila është anëtare e të njëjtit grup të zgjeruar të lidhur (sikurse është përkufizuar në seksionin [1471 \(e\)\(2\)](#) pavarësisht fjalisë së fundit të saj) si një korporatë e përshkruar në nënparagrafin (A),

(C) çdo entitet i cili është organizuar sipas ligjeve në posedim të Shteteve të Bashkuara dhe e cila tërësisht është në pronësi të një apo më tepër rezidentëve bona fide (sikurse është përkufizuar në seksionin 937(a)) të posedimit të tillë,

(D) çdo qeveri e huaj, çdo nënndarje politike e një qeverie të huaj, apo çdo agjenci me pronësi të plotë apo instrument i ndonjë apo më shumë të përmendura më parë,

(E) çdo organizatë ndërkombëtare apo çdo agjenci me pronësi të plotë apo instrument të përmendur,

(F) çdo bankë qendrore e huaj e emetimit, apo

(G) çdo klasë tjetër e personave të identifikuar nga Sekretari për qëllime të këtij nën-seksioni, and

(2) çdo klasë tjetër e pagesave të identifikuara nga Sekretari për qëllime të këtij nën-seksioni për aq sa paraqesin rrezik të ulët të evazionit tatimor.

(d) Entitet i huaj jo-financiar

Për qëllime të këtij seksioni, termi "entitet i huaj jo-financiar" nënkupton çdo entitet të huaj i cili nuk është institucion financiar (sikurse është përkufizuar në seksionin [1471 \(d\)\(5\)](#)).

LII nuk ka kontroll mbi ose nuk vërteton ndonjë faqe të jashtme të Internetit që përmban lidhje (linqe) për apo referenca LII.